



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.16/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Naim Mehulli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Driton Govori, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbarduesit Privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , duke vendosur lidhur më ankesën e paraqitur nga

me seli nga lidhur me veprimet përmbardimore në lëndët përmbardimore P.nr.194/2025, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Burbuqe Spahija Kërveshi, i autorizuari i palës ankuese the personalisht Përmbarduesi Privat, me datën 17.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET ankesa e paraqitur nga pala ankuese, me seli nga si e pa bazuar.

II. Përmbarduesi Privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P.nr.194/2023.

A r s y e t i m

Me datën 04.09.2025, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbarduesit Privat, me të cilën pretendon se përmbarduesi e ka shkel ligjin sepse kamata e llogaritur ne kundërshtim me titullin përmbardimor, në rastin konkret sa i përket kamatës është tejkualuar aktgjykimi dhe janë ndryshuar format e kalkulimit të kamatës ne kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit si titull përmbardimor. Po ashtu ka shtuar se sipas LMD-se kamat ligjore

në asnjë rast nuk mund ta kaloj borxhin kryesor e në këtë rast borxhi kryesor ishte 34,174.00, ndërsa kalkulimi i kamatës sipas ekspertizës e të cilën e ka lejuar përmbauesi është ne shumë prej 39,833.20 euro. I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndermirën masa ndaj përmbauesi privat.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaumin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë dhe mbetet në tërësi pranë raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 17.11.2025.

Përmbauesi Privat, ne deklaratën me shkrim të datës 16.09.2025, ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjëse për asnjë nga veprimet e ndërmarra përmbaimore në këtë rast duke shtuar se kalkulimi i kamatës është bere konform dokumentit përmbaimator dhe se në gabimet në vendime të gjykatës përmbauesi nuk ka kurrfarë të drejta ta bëjë ndryshimin dhe nuk ka tagër të vendos ndryshe nga dispozitivi-titulli përmbaimator, përmbauesi zbaton strik formalisht dispozitivin e aktgjykimin, ndërsa sa përket tejkallimit te borxhit kryesor me shumen e kalkuluar të kamatës ka deklaruar se e ka zbatuar ekspertizën në mënyrë rutinore dhe se ka konsideruar ma shume si gabim formal dhe se pas vërejtjeve të debitorit lidhur me shumen e cila e ka tejkalluar borxhin kryesor me dt.02.09.2025 ka urdhëruar kreditorin ta kthej dallimin në shume prej 5,659.20 euro e cila shume përmes përmbaues me dt.05.09.2025 i është kthyer debitorit në llogarinë e tij.

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbaimore, i përcakton shkeljet përmbaimore për përmbauesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbauesi privat tejkallon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbauesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbauesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbauesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. Nëse përmbauesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbauesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. Nëse përmbauesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbauesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. Nëse përmbauesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbaimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;

- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe

- 1.11. Nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së lartcitur, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Komisioni Disiplinor, vlerëson se Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet e lart cituar të nenit 367 të LPP-së, sepse në këtë rast përmbaruesi privat nuk ka bërë ndonjë tejkalim të autorizimit të dhënë me ligj sepse Konkluzioni e dt.21.08.2025 për caktimin e ekspertit financiar dhe mënyrën e përcaktimit të llogaritjes së kamatës për demin material dhe demin jo material e ka bazuar krejtësisht në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.684/18 i dt.22.06.2022 i plotfuqishëm me dt.17.12.2024 dhe i ekzekutueshëm me dt.27.03.2025. Në rastin konkret gabimet me ngatërrimin e demit material me demin jo material e të cilat pastaj janë reflektuar te llogaritja e kamatës nuk ishin me lëshimet e përmbaruesit privat pasi nga shkresat e lendes vërtetohet se këto gabime janë me lëshimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë e cila në aktgjykim C.nr.684/18 dt.22.06.2022 e ka ngatërruar demin material dhe jo material, kjo vërtetohet edhe me aktgjykim e Gjykatës së Apelit Ac.nr.5858/22 dt.17.12.2024 e cila e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, mirëpo e ka konsideruar si gabim teknik ngatërrimin e demit material me demin jo material, dhe se në këtë rast pala ankuese në momentin e pranimit të këtij aktgjykimi ka mundur të kërkojë korrigjimin e këtij gabimi teknik të lëshuar nga Gjykata e Shkalle së parë, prandaj në këtë rast nuk ka lëshim nga përmbaruesi privat i cili vetëm e ka zbatuar aktgjykimin e lartcekur. Në rastin konkret, përmbaruesi privat nuk mban përgjegjësi konform dispozitave ligjore në fuqi, pasi çështja që ka të bëjë me mënyrën e vendosjes në dispozitiv të aktgjykimit i cili ka shërbyer si titull përmbarimor në këtë rast, nuk hyn në juridiksionin dhe kompetencën e përmbaruesit. Vlerësimi lidhur me mënyrën e vendosjes kur dokumenti përmbarimor është aktgjykimi është kompetencë ekskluzive e gjykatës që ka nxjerrë vendimin, dhe si i tillë nuk mund t'i atribuohet përmbaruesit privat. Në rastin konkret, urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e një dokumenti përmbarues – vendimi i gjykatës – dhe përmbaruesi vetëm ka ndërmarrë veprimet procedurale për ekzekutimin e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për përmbarimin. Prandaj, çdo parregullsi eventuale që ka të bëjë me mënyrën e vendosjes si në aktgjykimin i cili ka shërbyer si titull përmbarimor në këtë rast nuk mund të përbëjë shkak për përgjegjësi të përmbaruesit, përderisa ky i fundit ka vepruar në përputhje me dokumentin përmbarues të lëshuar nga autoriteti kompetent gjyqësor. Ndërsa sa i përket tejkalimit

te borxhit kryesor me kamat një gabim i tillë është lëshuar fillimisht nga eksperti financiar dhe se përmbaruesi e ka korrigjuar këtë gabim duke urdhëruar kreditorin kthimin e shumës e cila kishte tejkaluar borxhin kryesor dhe se përmbaruesi këtë korrigjim e kishte bërë para datës së inicimit të kësaj procedure konkretisht me konkluzion dt.02.09.2025, ndërsa shuma është kthyer te debitori me dt.05.09.2025.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPSDPLS.nr.16/2025 datë 17.11.2025

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Naim Mehollu



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.